

e tij i ndaluan si peng pranë shkollës. Pas kësaj, Pjetri shkoi me pushkën e kërkuar. Nga ajo ditë, për të dhe Pashkun janë zhdukur të gjitha gjurmët. Personin e tretë, i cili ishte me ta, e liruan po atë ditë dhe ai, më vonë, u tregoi familjarëve të Pashkut dhe të Pjetrit se persona të panjohur, pas ndalimit të tyre, i kishin çuar në shtabin e UÇK-së. Zhdukja e tyre është evidentuar në evidencën e KNKK-së. Rasti i Pjetrit e mban numrin rendor BLG-803203-01, ndërkaq ai i Pashkut BLG-803202-01.

**Burimet:** deklarata U.P, FDH-29924; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Muhamet (Avdyl) Zeneli

(21.09.1975, shqiptar nga Jablanica/Jablanica, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Muhameti ishte aktivisht i angazhuar në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës që nga viti 1993. U inkuadrua në UÇK kur filluan konfliktet e armatosura. Ishte i pozicionuar në fshatin e vet të Jabllanicës/Jablanica. Ofensiva e parë e forcave serbe kundër fshatit ka nisur më **24.05.1998**. Muhameti gjendej në pozicionin e quajtur *Shtraza/Štraza [Jabllanicë/Jablanica]*. Gjatë depërtimit drejt këtij lokaliteti me tanke dhe këmbësori, forcat serbe e qëlluan Muhametin për vdekje. Kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati më 28.05.1998, familjarët u kthyen në shtëpi dhe e varrosën Muhametin në varrezat e Jabllanicës/Jablanica.

**Burimet:** deklarata A.Z, FDH-29791; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Halit (Asllan) Asllani

(18.03.1961, shqiptar nga Brovina/Brovina, komuna e Gjakovës/Đakovica, ekonomist, pjesëtar i UÇK-së)

Haliti u inkuadrua në UÇK në pranverën e vitit 1998. U plagos rëndë gjatë betejës me forcat serbe, e cila më **29.05.1998** u zhvillua në fshatin **Brovinë/Brovina**. Edhe pse pjesëtarë të UÇK-së e bartën menjëherë në Nivokaz, ai po atë ditë dha shpirt. U varros, po ashtu, në të njëjtën ditë në Nivokaz. Pas përfundimit të luftës, në verën e vitit

1999, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në vendlindje, në fshatin Brovinë/Brovina.

**Burimet:** SHFDUÇK, *Feniksët...8, 27*; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 182, FDH-23816; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Dragan (Vojislav) Ignjatović

(23.03.1972, serb nga Brestoci, komuna e Bojnikut, një fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

### Vojkan (Petar) Matić

(21.10.1977, serb nga Trnjani, komuna e Aleksincit, elektroteknik, pjesëtar i UJ-së)

### Dušan (Vojislav) Tasić

(15.06.1977, serb nga Pozharevci, auto-elektricitist, pjesëtar i UJ-së)

Dragani, Vojkani dhe Dušani ishin pjesëtarë të Brigadës së Motorizuar të 549 të UJ-së. Dragani ishte rreshter, ndërsa Dušani dhe Vojkani gjendeshin në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak. Kanë qenë të stacionuar në kazermën e Gjakovës/Đakovica. Përpara shkuarjes në ushtri, Dušani punonte kohë pas kohe për sektorin privat. Vojkani ishte djalë hasreti dhe pas ushtrisë dëshironte tu ndihmonte prindërve në barnatoren e tyre bujqësore.

Në datën **29.05.1998**, Dragani, Dušani dhe Vojkani, si dhe dy pjesëtarë të tjerë të UJ-së, u nisën me një autobлиндë më qëllim vëzhgimin e zonës kufitare. U ndalën në fshatin **Smolicë/Smonica** për ta kryer nevojën. Në ato çaste, dikush nga ta pahiri e aktivizoi një granatë dore, e cila i plagosi që të gjithë ata. Pasi që ndihma e shpejtë u vonua, Vojkani dhe Dragani ndërruan jetë nga gjakderdhja vdekjeprurëse. Dushani ka dhënë shpirt përderisa e transportonin për në AMU në Beograd. Familjarët e Vojkanit e kanë marrë trupin e tij një ditë më vonë. Ai u varros në varrezat e Trnjanit më 31.05.1998; Dušani në varrezat e Pozharevcit më 1.06.1998, ndërsa Dragani në varrezat në vendlindje në Brestocin e Epërm.

**Burimet:** deklarata Z.M, FDH-25856; FHP, *Haški tribunal, Sudeње Slobodanu Miloševiću*, XX, 702; *Dnevnik od 25. maja. do 1.juna*, Ilustrovana politika, FDH-16958; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 29, 40 i 68; KMKKRF, *Personat...*